

RILINDASI

Viti III - Nr:19

E diel, 12 maj 2013

Kryeredaktore: Admirina PEÇI

Na ndiqni
edhe
online

WWW.SHQIPTARJA.COM


PRIJESAT SHQIPTARE NE VJENEN E 1917

Ja fotot e panjohura dhe portretet e fisnikëve

NGA PJETER LOGORECI

Në mesin e prillit të vitit 1917, një delegacion prej 34 shqiptarësh, të ftuar nga komandanti i forcave ushtarake austriake që gjëndeshin në territoret shqiptare, gjenerali Ignaz Freiherr Trollmann, vizitoj kryeqytetin perandorak austriak Vjenë.

Delegacioni që arriti në Austri me 17 prill, u prit në stacionin qëndror hekurudhorë nga shumë personalitete ushtarake dhe diplomatike perandorake, si gjeneralet Trollmann e Myrdacz, gjenerali Ritter von Gross, konsulli Rudnay si dhe gazetari i njohur perandorak Leo Freundlich (i cili ka shkruar e dokumentuar të detajuara momentet e vizitës së delegacionit shqiptar gjatë gjithë kohës, të cilat janë referenca ime në këtë shkrim).



NË FOTO: (Lart në rreth) Dom Nikollë Kacorri ndërsa u prin fisnikëve shqiptarë gjatë vizitës në Vjenë në prill 1917. Në foto të tjera princat shqiptarë të fotografuar në momente të ndryshme gjatë vizitës në Vjenë

Qellimi i ardhjes së përfaqësuesve shqiptare ishte një takim nderimi me perandorin e ri Karl, si dhe për të bërë homazhe tek varri i perandorit Franz Josef.

Delegacioni, në përbërje të cilit ishin burrat më në zë (prijës) nga të gjithë territoret shqiptare, bëri përshtypje të madhe në qytet. Prijësit e fisëm malësore shqiptare të veshur me kostumet e tyre kombëtare, shumëgjyreshë, të qëndisur me fije ari, ndiqeshin me vemendje nga vjenezët, gjatë vizitave të tyre të shumta në pikat më të spikatura të qytetit. Njerëzit ishin të befasisur nga pamja kranare e burrërore e këtyre burrave shtatëlarhtë me mustaqe kreshnikësh që njiheshin deri atë herë vetëm në shkrimet apo veprat e publikuara nga studiuesit albanolog austriakë. Turma kureshtare njerëzish...

...vijon në faqen 16-18

Diplomat e Balshajve të shekullit XIV në arkivin e Dubrovnikut

Diploma e 30 nëntorit të vitit 1373 prezantohet për herë të parë në këtë formë të plotë para studiuesve, historianëve, por edhe lexuesit të gjerë me faksimile dhe e përkthyer në shqip...

DR. MUSA AHMETI

Dinastia e Balshajve ishte njëra prej dinastive më të njohura shqiptare në shekujt XIV - XV. Nga kancelaria e tyre që vepronte në disa gjuhë, e që për fat të mirë na janë ruajtur një numër i konsideruar dokumentesh të lëshuara nga kjo kancelari, kemi vendosur të botojmë të shoqëruara me faksimile, të transkriptuara [tejskronjizuara] në sllavishte të vjetër, të përkthyer në shqip dhe të shoqëruara me komente përkatëse sa më përmbajtëse duke shmangur për aq sa është e mundur "detajet e lodhshme" të diplomatikës, sfragjistikës, heraldikës, sigjilo-

grafisë e paleografisë. Lëndë burimore-dokumentare e pabotuar ose pjesërisht e botuar për Balshajt, dhe në përgjithësi për mesjetën shqiptare gjendet në shumë arkiva evropiane, por në sasi të konsiderueshme sidomos në arkivat e Dubrovnikut. Botimi i kësaj lënde dokumentare është nxjerrë nga Arkivi Shtetëror i Dubrovnikut dhe i përket gjysmës së dytë të shekullit XIV. Të gjitha diplomat janë shkruar në sllavishte mesjetare - cirilikë - dhe janë lëshuar nga kancelaria e Balshajve në periudhën kohore 7 janar 1368 - 3 nëntor 1395. Botimi i këtyre burimeve sipas metodave bashkëkohore shkencore të editimeve...

...faqe 20-21



Gjinestra, vendi ku rrugët kanë dy emra

Historia e një gazetareje nga Torino gjatë vizitës së saj në Basilicata. Këtu banorët flasin dy gjuhë, kisha është e zbukuruar me mozaikë dhe ikona bizantine si dhe Shenjtori ka origjinën nga Lindja.

...faqe 22

Konstandin Leka, një libër me kujtime për Radio Tiranën

Në librin "Një jetë në shtjelljet e krijimtarisë", Leka rrëfen pasojat e mohimit të emrit në krijimtarinë e tij. "Si m'u hapën rrugët në Radio Tirana. Kontributi i personazheve që më ndihmuan në krijimtarinë time"

DHURATA HAMZAI

Libri "Një jetë në shtjelljet e krijimtarisë" i Konstandin Lekës ka sjellë përmes kujtimeve aktivitetin e tij krijues, i cili gjatë periudhës së diktaturës është mbuluar nga një heshtje e plotë në gjithë organet e masmediave të kohës. Autori i librit e vlerëson punën e tij dhe të kolegëve si një krijimtori të rëndësishme kombëtare, por ajo edhe pse kishte jehonë, pasoi me një heshtje të thellë mbi emrin e tij, sikur kjo krijimtori nuk ka ekzistuar. "Pati mohim dhe urrejtje të plotë zyrtar. Justifikimi bazë ishte gjithmonë i njëjti: origjina tregtare e familjes sime, që shfrytëzohe lehtësisht

si prej "vigilentëve", por veçanërisht prej smirëzinjve. Për çdo krijimtori përsëritej pothuaj i njëjti skenar", thotë Konstandin Leka. Cilat ishin pasojat e heshtjes mbi krijimtarinë e një krijuesi që bënte me përpikmëri atë që dëshironin drejtuesit e institucionit. "Edhe sot janë të shumtë bashkëpunëtorët dhe studiuesit që duan të shkruajnë, por ankohen se nuk gjejnë asnjë dokument dhe informacion mbi këto aktivitete. Edhe në rastin e ngritjeve të linjave të tëra prodhimi, nuk është bërë asnjë njoftim dhe inaugurim zyrtar", rrëfen Leka pasojat e mohimit të emrit në krijimtarinë e tij. Ndaj në vitet demokratike autori i librit kërkon...

...faqe 19

FOTO | DOKUMENTE

NGA PJETER LOGORECI

vijon nga faqja 15

...mbushnin trotuaret, kur delegacioni kalonte në makina luksoze, pajtonet karakteristike vjen-eze apo në ndonjë vagon special tramvaji, për të shijuar bukuritë e qytetit më në zë evropian. Grupi shoqërohej nga Profesorët Gjergj Pekmezi dhe Kolë Rrota që jetonin e punonin në Vjenë.

Në arkivat e ministrisë së jashtme të kohës së perandorisë Austro-Hungareze, gjinden informacione konfidenciale, të cilat janë dërguar (në shifër) nga konsulli austriak në Shqipëri Kral, ministrit të jashtëm kontit Ottokar Czernin, në Vjenë. Dokumentet janë lista që përmbajnë emrat e të ftuarve, e ku për secilin të ftuar, gjndet një pershkrim i shkurtër biografik i bërë nga konsullatat austriake në Shqipëri. Dokumenti i parë është dërguar nga Shkodra dhe mband datën 10 prill 1917. Listat janë te formuluar sipas ndarjeve te rretheve apo qyteteve:

BEZIRKU I - RRETHI I SHKODRES

1. Musa Efendi Juka, Kryetar Bashkie i Shkodres, rrjedh nga një familje e përmendur shkodrane. Në kohën e turkut ai ishte nëpunës i lartë i financave në vilajetin e Shkodrës. Mbas pushtimit të qytetit nga malazezët (1913) u largua për në Konstantinopol, por me pas u kthye përsëri në Shkodër ku ndihmoi shumë në përhapjen e politikës së turqve të rinj. Për këtë arsye, mbas pushtimit të dytë të qytetit nga malazezët (1915), u mbajt në burg për një muaj. Eshhtë Kalorës i urdhërit të Franz Josefit.

2. Kol Ujka, tregtar (ka zëvendësuar Gjon Çobën i cili për arsye shëndetsore ka lajmëruar mos marrjen pjesë në grup).

Gjon Coha, vjen nga një familje e njohur katolike shkodrane. Babai i tij ishte për 40 vjet përkthyes i konsullatës së pergjithëshme austriake në Shkodër, punë të cilën e ka kryer me nder. Ai ka mbajtur me ne lidhje të ngushta e për këtë në vitin 1915 u internua nga malazezët e Podgoricës. Ai është si babai i tij, një tregëtar i madh.

3. Hassan Efendi Bekteshi, rrjedh nga një familje e vjetër shkodrane. Eshhtë tregëtar i madh. Gjyshi i tij, ishte në kohën e vezirit Mustafa Pasha "Kuluktishibash", postëkomandant i Shkodrës, babai i tij ishte "Bylykbash", përfaqësues i malësive në Shkodër. Hasan Efendi është politikisht në anën tonë. Në vitet 1914/1915 ndihmoi politikën e turqve të rinj, që vepronte kundër Essad Pashës, prandaj u kap dhe u burgos nga malazezët për një muaj.

4. Vat Marashi, Bajraktar i Shkrelit. Mudir (administrator) i Pulaj në kohë të turkut dhe të fuqive nderkombëtare. Ai kishte lidhje shumë të mira me autoritetet turke, por pas qëndrimit të njëanshëm poshtëruës të turqve u vendos në krah të malësorve. Në pushtimin e parë nga malazezët u internua si mbeshetës i turqve. Ai është një politikan i mirëfilltë dhe një orator i talentuar.

5. Gjelosh Gjoka, Vojvoda i Kastratit, bashkëpunetori ynë i

sinqertë. Ishte në shërbim të princit Wied në Durrës e mbas ikjes së tij u kthye në Kastrat përsëri. Kur ushtritë malazeze kaluan kufirin shqiptar ai largohet për në Shkodër (1915). E gjithë pasuria e tij u plaçkit dhe u dogi në mungesë të tij. Eshhtë mbajtës i kryqit të arit për merita.

6. Abdi Kola, Bajraktari i Shoshit

7. Hasan Ahmeti, Vojvoda i Postripës

NË FOTO:

(Në rreth)

Dom Nikollë Kaçorri ndërsa u prin fisnikëve shqiptarë gjatë vizitës në Vjenë në prill 1917. Në foto të tjera princat shqiptarë të fotografuar në momente të ndryshme gjatë vizitës në Vjenë



Dom Nikollë Kaçorri u prin

Shtatë foto surprizë të delegacionit shqiptar prej 34 fisnikësh gjatë vizitës një javore në Vjenën e 1917. Shënimet e hollësishme që la gazetari i njohur perandorak Leo Freundlich shoqëruar me faksimilet e marra nga arkivi vjenez



Të dhënat e delegatëve
Në arkivat e ministrisë së jashtme të kohës së perandorisë Austro-Hungareze, gjinden informacione konfidenciale, të cilat janë dërguar (në shifër) nga konsulli austriak në Shqipëri Kral, ministrit të jashtëm kontit Ottokar Czernin, në Vjenë. Dokumentet janë lista që përmbajnë emrat e të ftuarve, e ku për secilin të ftuar, gjndet një pershkrim i shkurtër biografik i bërë nga konsullatat austriake në Shqipëri

BEZIRKU II - PËR LEZHËN:

8. Mano Bey Mehmed Bey, rrjedh nga një familje shumë e vjetër dhe e përmendur nga Lezha. Babai, gjyshi si edhe ai vetë ishin Mudir të malësisë së Lezhës. Familja e tij është pronare e madhe tokash.

9. Ded Çoku nga Bregu i Matit, vjen nga fisi Klementi (Nikci), ishte përpara shumë i pasur, por e humbi një pjesë të pasurisë (tokave) për shkak të rebelimit të tij kundër pushtetit osman, luftës

kundër rebelëve të Shijakut dhe kundër Essad Pashës. Ai është nacionalist i flaktë shqiptar dhe përkrahës i hapur i Austro-Hungarisë. Ka luftuar në anën tonë kundër armiqve të përbashkët. Eshhtë mbajtës i Kryqit të artë për merita të veçanta.


10. Mehmed Bey nga Lezha

BEZIRKU III - PËR PUKË E MIRDITË

11. Kapitan Nue Gjoni, vëllai i kapitanit të Mirditës Marka Gjoni, kushëri i Prenk Bib Dodës. Pasard-



fisnikëve shqiptarë në Vjenë



hës i familjes së përmendur Gjon Markaj nga Oroshi. Përkrahës i monarkisë Austro-Hungareze. Mori pjesë në luftimet kundër rebelëve të Shijakut, kundër serbëve dhe Essad Pashës.

12. Zef Ndoci, Vojvoda i Spacit (i biri i Ndoc Ndreçës, komandant i Mirditës në kohë të turkut). Ka qenë për shumë vjet mësues në shkollën e famullisë së Spacit. Mori pjesë aktive në qëndresën kundër turqve, në luftën kundër serbëve dhe kundër Essad Pashës,

të cilit i shkaktoj dëme të mëdha. Shqiptar nationalist dhe simpatizant i monarkisë Austro-Hungareze. Mbajtës i kryqit të artë për merita të veçanta.

13. Zejnel Aga Ibalja, Vojvoda i Iballës, nga një familje shumë e përmendur dhe e pasur. Ai luftoi bashkë me Bajram Bey Currin kundër serbëve dhe Essad Pashës në krah të prinzit Wied. Eshhtë i njohur për miqësinë me ne.

BEZIRKU I V

14. Muharrem Pengili nga Kruja, përpara Mufti, tashti Naib-Mufti në Krujë. Një klerik shumë i njohur dhe shumë burrëror muhamedan.

15. Ahmed Bey nga Mati, përfaqësues e trashëgimtar i fisit zotërues të Matit, Zogolli që trashëgoj nga rregimi turk ofiqin Kajmakam. Luajti një rol të rëndësishëm në autonominë e Shqipërisë. Luftoj kundër serbëve dhe ishte një kundërshtar i Essad Pashës. Vuri në dispozicion të ushtrisë tonë kur hymë në Shqipëri, 4000 – 5000 luftëtarë vullnetarë të cilët luftuan në frontin pranë Vjosës. Eshhtë nderuar me urdhërin më të lartë të Kaiserit Franz Josef.

BEZIRKU I V – RRETHI I TIRANES

16. Mussa Maçi, përpara ishte Kryetar Bashkie, familje me zë, tregtar dhe qytetar tiranas me ndikim shumë të madh në Tiranë.

17. Xhelal Bey, nga familja e Toptanve, kushëri por kundërshtar i Essad Pashës. Pronar i madh tokash. Politikan dhe burrë i mencur.

PER DURRESIN

18. Izzeddin Beshiri, ishte përpara Nën-Perfekt e tashti Kryetar Bashkie i Durrësit. I ri në moshë, por shumë inteligjent dhe i gatshëm të ndihmojë kudo. Vjen nga një familje e mirë. Bashkëpunëtor i zellshëm i administratës tonë qysh në fillim të okupimit. Mban kryqin e artë me kurorë për merita të veçanta.

19. Monsignor Nikollë Kacorri, Protonotar Papnure, famullitar i Durrësit, nationalist dhe mbështetës i monarkisë Austro-Hungareze. Prift i përkushtuar. Burrë me inteligjencë e per-

sonalitet të veçantë.

PER KAVAJEN

20. Kassim Bey, nga një familje e përmendur. Shumë i pasur, Kryetar Bashkie i Kavajës.

21. Shehziyer Bey, nip i Eliaz Pashës nga Dibra – Ohri. Nip i të shumë njohurit e të nderuarit nga Shqipëria e mesme Aqif Pashës. Ka ndihmuar gjatë ardhjes së trupave tona dhe bullgare me vullnetare. Në gjashtë muajt e parë të vitit që shkoi ishte Perfekt i Elbasanit. Eshhtë i dekoruar si kalorës i Franz Josefit.

PER ELBASANIN

22. Lef Nossi, i besimit ortodoks, nga një familje e pasur tregtare kristiane, me gjithë rrezikun e madh në kohë të qeverisë turke, ka organizuar njerëzit, shumica nga banorët ortodoks të Elbasanit, për një lëvizje nacionale shqiptare.

Ishte ministër për postë dhe telegraf në qeverinë e Ismail Qemal Beyt dhe sekretar i përgjithshëm në të njëjtin ministri në kohë të Wiedit.

23. Irfan Bey nga Elbasani, nip i Aqif Pashës

PER BERAT E SKRAPAR

24. Sami Bey Vrioni, pjestar nga familja e vjetër Vrioni që janë zotërues tokash e pasaniket latifondistë më të mëdhenjtë në zonën e Devollit. Eshhtë dhëndëri i Essad Toptanit, ishte Administratori i oborrit (Hofmarschall) te Prinz Wied-it.

25. Mehmed Essad, një klerik muhamedan shumë i përmendur, përpara ishte myftiu i Beratit, tashti drejtues i seminarit muhamedan aty.

26. Demeter Lavda, i besimit ortodoks grek, burrë i përmendur dhe tregëtarë i njohur.

PER LUSHNJEN

27. Ahmed Bey Resuli, vjen nga një familje e vjetër dhe e përmendur, shumë i pasur.

28. Emin Vokopola, një burrë me shumë autoritet, shumë i njohur dhe pasanik.

PER FIERIN

29. Kahreman Bey Vrioni, kushëri i afert i Samy Bey Vrionit, i pasur dhe i nacionalist. Luftoj si oficer kundër rebelëve dhe Essad Toptanit, ka arritur suksese të mëdha në këtë luftë duke i prirë trupave tona, eshtë i besuari jonë dhe eshtë Kalorës i urdhërit të Franz Josefit.

BEZIRKU I VI – ZHURI – PESHKOPIJA

30. Elez Jussuf, eshtë një burrë shumë i njohur dhe me autoritet në zonat e Drinit nga Dibra.

vijon në faqen 18

FOTO | DOKUMENTE

vijon nga faqja 17

Eshtë i besuari ynë, bëri qëndresë ndaj disa grupeve në Dibër duke propaganduar influencën geqe. Kundërshtoi hapur propagandën e partisë së Essad Toptanit. Luftoi në krye të vullnetarëve kundër serbëve deri në tërheqjen e tyre. U vu në shërbim të forcave tona dhe ka fituar për merito lufte urdhërin e lartë si oficer i Franz Josef.

31. Salih Spahija nga Luma, është përfaqësues i familjes më të rëndësishme në Lumë, ka luftuar kundër serbëve, është nënprefekt në administratën tonë. Ka shumë influencë.

PER KRASNICIN

32. Hysni Bey Curri, nip i Bajram Bey Currit. Në kohën e reformave në Maqedoni (1914), bashkë me Bajram Curri ishte ndjekës i Hysni Hilmi Pashës, inspektorit të komisionit të reformave. Në kohën e revolucionit të Kosovës (1910) bashkë me Bajram Curri mori pjesë në qëndresën e shqiptarëve kundër qeverisë turke. Në të njëjtën kohë mori pjesë në çdo lëvizje e qëndresë kundër sllavëve si dhe në luftimet e Princit Wied në Durrës.

33. Sali Mani Bunjaj, është pjestar i një familje të njohur dhe të pasur. Ka qenë dhe është kurdoherë një ndjekës i Bajram Currit.

34. Hasan Bey Prishtina, është një nga njerëzit më të përmendur, nacionalist dhe me influencë në të gjitha zonat verilindore që janë shqipfolëse. Ishte ministër në qeverisjen e princit Wied.

Delegacioni në shoqërinë e gjeneralit Trollmann vizitoi shumë objekte të artit, të kulturës e të historisë së perandorisë. Vizitën e parë e bëri tek Dhoma e Thesarit të perandorisë prej ku më pas në Muzeun e Artit ku patën rastin të njihen e të kundrojnë nga afër armët dhe përkrenaren e heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti që ndodhet në dhomën e koleksionit të armëve. Një vizitë tjetër e rëndësishme ishte edhe në katakombet e kishës së Kapucineve ku ndodhen varrezat e pjestarëve të familjes perandorake dhe sarkofagu i Kaiserit Franz Josef, i cili kishte pak muaj që kishte vdekur (21 nëntor 1916).

Këtu u vendos një kurorë me lule dhe u mbajtën fjalime falenderuese, nga Gjergj Pekmezi dhe Hasan Prishtina, në nderim të perandorit të vdekur. Ditët e tjera, u mundësuan vizita në Muzeun ushtarak, Katedralen madhështore të Shën Stefanit në qendër të qytetit, e më pas u bë edhe audienca ku delegacioni ynë u prit nga Perandori Karl dhe Perandoresha për rreth 45 minuta. Në emër të shqiptarëve



NË FOTO: Faksimile të shënimeve të mbajtura nga konsulli Kral dërguar Ministrisë së Jashtme në Vjenë

Kush janë 34 prijësat e ftuar nga perandori Karl në prill 1917



zotëri Xhelal Toptani i dhuroj princeshës së vogël tre vjeçare, një fustan të qëndisur me fije ari, punë dore e nënave shqiptare. Nga takimi me perandorin, shqiptarët të hyhur ndër 10 makina ushtarake, vizituan bashkinë e Vjenës ku u pritën me nderime nga kryetari Dr. Weiskirchner. Sipas programit të vizitës,

delegacioni shijoi dhe bukurinë e "vallëzimit të kuajve të racës" në shkollën spanjole të kuajve të oborrit perandorak, më pas u njoh me koleksionet e pashembullta e unikale të muzeut të natyrës, të cilin perandori e kishte ndërtuar për të kënaqur ndjesitë e tij dhe për ti treguar botës fuqinë dhe pasurinë e perandorisë.

Gjëja më interesante në ditën e tretë të ardhjes, ishte shkuarja e grupit në operanë e famëshme të Vjenës ku atë natë luhej "FIDELIO". Për shumë pjesëtarë të delegacionit kjo ishte një risi që nuk kishin pasur mundësi më perpara ta shijonin. Me 20 prill, shqiptarët u pritën në ministrinë e mbrojtjes (të

luftës) ku këmbyen me ministrin falenderime e lavde reciproke e më pas delegacioni vizitoi kështjellën e Schönbrunnit me bukuritë e saj që e rrethojnë. Në orët e vona të natës një pjesë e delegacionit ishte parashikuar të largohej nga Vjena në drejtim të atdheut e për tu organizua nga autoritetet një festë përcjellje.

Në programin javor ishte edhe një takim me fëmijët shqiptarë, të cilët shkolloheshin në Vjenë e që jetonin në një konvik të veçantë vetëm për to, në Krottenthalergasse.

Ajo që bëri përshtypje në festën madhështore të lamtumirës ishte fjala që mbajti komandanti i forcave austriake në Shqipëri, gjeneralit Trollmann, i cili përshëndeti fisnikët shqiptar për ndihmën e madhe të dhënë për organizimin e ndihmave, të ushtrisë e vullnetarëve. Në fund të fjalës së tij ai thirri në gjuhën shqipe: RROFTE SHQIPNIA...

Më pas e mori fjalën Imzot NIKOLLE KAÇORRI, i cili tha që shqiptarët ishin më se të kënaqur për pritjen e bërë në këtë qytet të mrekullueshëm për nga bukuria e kultura. Në emër të gjithë të deleguarve ai falenderoi për pritjen e ngrohtë që u bëri atyre PERANDORI dhe autoritetet e tjera të shtetit e të qytetit. Në fund Imzot Kacorri me fjalë të ngrohta falenderoi dhe i dëshëroi gjithë të mirat gjeneralit Trollmann për simpatinë që ai ushqente për popullin shqiptar, urim që u brohorit nga të gjithë të pranishmit pjestarë të delegacionit. Delegacioni shqiptar u nis për në atdhe me 23 prill 1917.

SHËNIM:

Imzot Kaçorri vdiq pas afro një muaji në Wien (29 maj 1917) Wien, më 8 maj 2013